



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.50/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Nenad Laziç dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me zyrtarin ligjor, Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së banerëve në objekte publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.06.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Prishtinë, dhe subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1400 (njëmijë e katërqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 05.06.2017, nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend ka vërejtur një parregullsi të cilën e kanë evidentuar duke i bashkangjitur si dëshmi një fotografi e printuar nga vendi i ngjarjes. Parashtruesi i ankesës potencon se me datën 04.06.2017, në rrugën “Fazli Vata” që lidhet me rrugën “B” në Prishtinë, monitoruesi ynë ka hasur në poster të kandidatit për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) të ngjitur në hapsira publike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr.03/L-073 dhe konsideron se subjekti politik LVV ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur poster të kandidatëve për deputet në hapësira publike. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi nga vendi i ku ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatet.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, i datës 06.06.2017, ka pranuar shkeljen e pretenduar në ankesë duke arsyetuar se lidhur me këtë çështje është njoftuar shtabi zgjedhor dhe kemi marrë masa përmirësuese që ti largojmë materialet informuese për të cilat jemi njoftuar. LVV-ja ka vendosur posterët e kandidatit në murrë dhe se LVV-ja pas marrjes së ankesës nga ana e PZAP-it ka ndërmarrë masat përmirësuese, për evitimin e shkeljes sipas ankesës. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkangjitur një foto nga vendi ku është larguar posteri.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

## Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterat e kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik LVV janë vendosur në një murë në vende publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga prova e ofruar shihet qartë se nga ana e subjektit politik LVV, është shkelur neni 33 pika (b) i Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi që posterat e kandidatit për deputet nga subjekti politik LVV, janë vendosur në murrë publik të qytetit Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë subjekti politik LVV, në përgjigje në ankesë i datës 06.06.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, si në dispozitiv të këtij vendimi ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër këtij fakti posterat e kandidatit për deputet nga ky subjekt politik janë vendosur në murrë publik. Po ashtu si rrethanë PZAP-i morri parasysh faktin që subjekti politik në fjalë, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësin e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr.50/2017 më datën 06.06.2017.



**Kryesuesi i Panelit  
Fejzullah Rexhepi**

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konformi nenit 118 par. 4 të LZP-së.